Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0769

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani –Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE Komtel Project Engineering SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)" me numër të prokurimit UA/2016-23-7913-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit, më 10/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e Operatorit ekonomik" Komtel Project Engineering SH.P.K", me nr. 2023/0769 , e datës 06/10/2023, kundër" Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)", me numër të prokurimit UA/2016-23-7913-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit.

2. Mbetët në fuqi" Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" i datës 19.09.2023,i AK-Agjencia Qendrore e Prokurimit, për të shpërblyer me kontratë e OE "Arianit R. Bytyqi",lidhur me aktivitetin e prokurimit numër; UA/2016-23-7913-2-2-1.

3. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës ndaj e Operatorit ekonomik " Komtel Project Engineering SH.P.K", konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 28.07.2023 Agjencia Qendrore e Prokurimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)" me numër të prokurimit UA/2016-23-7913-2-2-1. Ndërsa me datën 19.09.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë e OE "Arianit R. Bytyqi".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 50,000.00 €.Me 02.10.2023, OE "Komtel Projekt Engineering" SHPK., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Komtel Projekt Engineering SHPK, me nr. 769/23 lidhur me aktivitetin "Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)" me numër të prokurimit UA/2016-23-7913-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues " Komtel Project Engineering SH.P.K",, janë parashtruar si në vijim;

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09.10.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 20.10.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK".

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet OE" Komtel Project Engineering SH.P.K", eksperti shqyrtues me raportin nr. 2023/0769 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi që ka të bëjë me çështje teknike, specifikisht të softuerit, mund të përshkruhet si në vijim: Eksperti teknik, pas analizës dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës së dosjes së tenderit, Aneksit 1 të specifikimeve teknike të detyrueshme - zhvillimi i platformës për aplikacione online DIGITARKEP, me theks të veçantë në ofertën e paraqitur nga OE i rekomanduar, dëshmia dhe referencat e prezantuara në lidhje me projekte të ngjashme të kësaj natyre, deklarata nën betim se do të zhvillojë Sistemin e Menaxhimit të Përmbajtjes (CMS) dhe modulet sipas kërkesave të Drejtorisë Teknologjike (DT) dhe teknologjisë që do të përdoret në zhvillimin e këtyre kërkesave të DT (12_UNISOFT_SpecifikimiTeknik_ARKEP v2.pdf), mund të konkludohet se, sipas

dëshmive të prezantuara, nuk kemi të bëjmë me një CMS të gatshëm, por kemi të bëjmë me zhvillimin e moduleve nga fillimi, sipas kërkesave të ARKEP të përshkruara në DT, të cilat do të kustomizohen ose integrohen në CMS të zhvilluar nga OE i Rekomanduar. Teknologjia e propozuar për zhvillimin e moduleve të tilla është MVC5 bazuar në .NET 4.8, pra kemi të bëjmë me një ueb të zhvilluar në .NET dhe SQL Server.

Prandaj, në këtë çështje, kemi të bëjmë me një CMS të zhvilluar posaçërisht nga OE i Rekomanduar. Fakti që ky CMS është zhvilluar nga kompania (siç është përmendur në dokumentin sqarues të tenderit, në përputhje me kërkesat e datës 25 Gusht 2023 sa i përket kërkesës për çmim minimalisht të ultë) për projekte të ndryshme të implementuara në entitete të ndryshme të prezantuara në referencat e kërkuara, nuk duhet të jetë problematik. Përkundrazi, ky fakt është një faktor pozitiv në lidhje me performancën e projektit. Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, pretendimi i OE ankues kundër vendimit të AK në lidhje me këtë çështje është i Pabazuar.

Tutje, pretendimi i OE ankues lidhur me mosdhënien e qasjes, ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK të njëjtit i ka ofruar qasje në versionin e pastruar sipas dispozitave ligjore të LPP-së, për faktin se OE i rekomanduar ka nënshkruar kërkesën për konfidencialitet të të dhënave.

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese dhe ai teknik i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues Komtel Projekt Engineering SHPK. Argumentimi në raportin e ekspertit teknik është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertes shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit teknik. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues Komtel Projekt Engineering SHPK, janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në

kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e Ekspertit Shqyrtues, ankesa e Operatorit Ekonomik OE" Komtel Project Engineering SH.P.K", Njoftimin për Kontratë, i datës 19.00.2023, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 27.09.2023, për aktivitetin e prokurimit "Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)", me numër të prokurimit UA/2016-23-7913-2-2-1.(AK)-Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues OE" Komtel Project Engineering SH.P.K", raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë konstatuar si të pabazuara.

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit, andaj Paneli përfundimisht ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit ekonomik " Komtel Project Engineering SH.P.K" dhe mbetet në fuqi "Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues" datës, 27.09.2023, i Autoritetit Kontraktues, Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit nr; UA/2016-23-7913-2-2-1. , pasi që eksperti ka sqaruar se nuk ka të bëjë me një CSM të gatshëm po me zhvillim të moduleve nga fillimi, e cila po ashtu sa i përket çmimeve AK ka marrë të mirëqenë shpjegimin e të njëjtit.

Operatorit ekonomik ankues" Komtel Project Engineering SH.P.K", pasi i refuzohet ankesa, i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues, bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Agjencia Qendrore e Prokuimit**
- OE - **Komtel Project Engineering SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: